



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJ MUAJI DHJETOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

Kuriozitete për stinën e dimrit



Çfarë duhet të dimë për Dimrin?

- * Muaji dhjetor është **muaji i parë i stinës** së dimrit, kur koha është **shumë e ftohtë** dhe në zonat malore bie borë.
- * Dhjetori është **muaji i fundit** i vitit.
- * Në dhjetor, **ditët janë shumë të shkurtra, ndërsa netët shumë të gjata** dhe të ftohta.
- * Frutat si: **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat, gështenjat**, ne i shijojmë në stinën e dimrit.
- * Dhjetori është **muaji i festave të fundvitit** në mbarë botën.

Muaji Dhjetor
Tema: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”
Grupmosha 6-18 muaj



- * **Java I:** Karakteristikat e stinës së Dimrit. Natyra në dimër dhe veshjet.
- * **Java II:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së dimrit.
- * **Java III:** Përgatitja për festën e Vitit të Ri.
- * **Java IV:** Programi festiv i Vitit të Ri.


Tema mujore: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”



Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Karakteristikat e dimrit. Veshjet e fëmijëve në dimër.	Njohja me elementët kryesorë të dimrit, si: moti shumë i ftohtë, era e fortë, shiu, bora, etj. Si të vishemi në dimër. Ndryshimi i veshjes sipas stinës.	Java I
Frutat dhe perimet e stinës së dimrit.	Njohja e frutave dhe perimeve përmes demonstrimit të përgatitjes së ushqimeve.	Java II
Përgatitja për festën e Vitit të Ri. Dekori, format, ngjyrat, numrat.	Njohja me elementët dekorues të festës së Vitit të Ri; Babagjyshi, bredhi, dhuratat, etj. Njohja me format, ngjyrat dhe numrat.	Java III
Programi festiv i Vitit të Ri.	Të festojmë së bashku.	Java IV


Tema mujore: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e javës: “Njohja me karakteristikat e stinës së dimrit”



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Natyra në dimër</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se në stinën e dimrit bën shumë ftohtë, bie borë dhe pemët, rrugët zbardhen. Nga i ftohti, pemët janë krejt të zhveshura dhe qielli është gri.</p> <p>Aktivitet: Vrojtojmë nga dritarja motin në dimër (shoqëruar me emërtimin nga edukatorja të elementëve natyrorë) si: retë, era, shiu dhe bora.</p> <p>Vjersha: “Bora e Bardhë”.</p> <p>Lojra: “Imitimi i lojës me topa bore” (Edukatorja përdor topa prej letre, topa të bardhë dekorues, etj).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p> <p><i>Borë moj e bardha borë, bjer shtruar ndonjë orë, sa të zbardhet fare toka dhe të luajmë ne me topa.</i></p>

<p>E Martë</p>	<p>Njeriu Prej Bore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve rreth borës, ngjyrës së saj, ku dhe kur bie më shumë. Me borën ne luajmë, formojmë njeriun prej bore.</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”.</p> <p>Aktivitet krijues: Me ndihmën e edukatoreve fëmijët vendosin njëra mbi tjetrën tre kuti të bardha, nga më e madhja te më e vogla. Më pas edukatorët (duke e shpjeguar me fjalë disa herë), pikturojnë mbi kuti fytyrën e njeriut të borës dhe e stolisin atë me kapele dhe shall.</p> <p>(Ky aktivitet ndihmon në koordinimin sy-dorë të fëmijës, me zhvillimin kognitiv dhe të motorikës fine).</p>	<p>Mjete Didaktike. Kuti të bardha, kapelle, shall. Manuali i Vjershave</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Veshja e fëmijëve në dimër</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve sesi vishen në dimër. Shpjegon se, për shkak të të ftohtit në dimër veshim rroba të trasha si pallto, shall, kapuç, doreza. Këto rroba na mbrojnë nga i ftohti, shiu, era e fortë e dimrit.</p> <p>Vjersha: “Shiu”/”Xhepi im i vogël”.</p> <p>Aktiviteti: I kujt është ky xhup? Fëmijët nxiten të njohin veshjet e tyre.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>


E Enjte	<p>Veshja e Bebit/shokut/shoqes</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve për rrobat që kemi veshur sot (në varësi të motit).</p> <p>Aktivitet: Edukatorja u ilustron fëmijëve se si vishemi në dimër, duke veshur një shok/shoqe të grupit. Njëkohësisht ajo stimulon fëmijët e tjerë që ta ndihmojnë, duke u kërkuar çorapet, bluzën, xhupin, këpucët etj. Kështu fëmijët janë interaktivë dhe aktiviteti ndihmon në zhvillimin kognitiv dhe të motorikës fine.</p> <p>Vjersha: “Shiu”/ “Xhepi im i vogël”</p>	<p>Manuali i Vjershave Veshjet e shokut/shoqes së grupit përkatës.</p>
E Premte	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e trajtuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”/”Shiu”/ “Xhepi im i vogël”</p> <p>Përrallë e lirë: Ilustrim i figurave (sipas librave që disponojnë në grup).</p>	<p>Manuali i Vjershave Libra, revista</p>

Tema mujore: Karakteristikat Stinës së Dimrit

Tema mujore: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e javës: “Frutat dhe Perimet e Stinës”



Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Njohja me frutat</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve përmes formave plastike, tablove dhe librave, frutat e stinës, si: molla, portokalli, mandarinat, etj.</p> <p>Vjersha: “Tren-tren, pi-pi tren”.</p> <p>Aktiviteti: “Edukatorja vendos/ngjit në një tabelë dhe/ose në mur shabllone me ngjyra të frutave të stinës, si: mollë (e kuqe dhe jeshile), portokall, shegë, mandarinë etj. Më pas u kërkon fëmijëve që të tregojnë me gisht një frut të caktuar, ose i stimulon fëmijët pak më të rritur që t’i japin asaj një frut (shabllon) të caktuar.</p> <p>Këngë lëvizore: “Duart nga e majta...”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista. Shabllone me fruta</p>


<p>E Martë</p>	<p>Njohja me perimet</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve përmes formave plastike, tablove dhe librave, perimet e stinës, si: lulelakra, brokoli, fasulet, thjerrëzat, spinaqi, karrotat, rrepkat, etj.</p> <p>Vjersha: “Tren-Tren Pi-Pi Tren”.</p> <p>Aktivitet (bazuar në menunë ditore) Edukatorja mund të marrë në kuzhinë thjerëza në një tas dhe të lejojë fëmijët që t’i prekin. Gjithashtu, edukatorja stimulon fëmijët që të marrin thjerëza në dorë dhe të mbyllin grushtin.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Thjerëza, tas.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Shijojmë frutat e stinës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve me fjalë sa më të thjeshta për dobinë e frutave dhe vlerat ushqyese të tyre.</p> <p>Aktiviteti: Përgatitet në kuzhinë lëng portokalli i shtrydhur dhe u jepet fëmijëve ta pijnë, ndërkohë që edukatorja vazhdon të flasë për rëndësinë e konsumimit të frutave.</p> <p>Këngë lëvizore: “Duart nga e majta...”</p>	<p>Lëng portokalli Manuali i vjershave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Panairi i frutave dhe perimeve.</p> 	<p>Aktivitet (bazuar në menunë ditore). Edukatorët vendosin të paprera nëpër pjata, frutat dhe perimet që do të konsumohen sot dhe i stimulojnë fëmijët që t’i prekin dhe t’i eksplorojnë ato (duke u kujdesur që të mos i fusin në gojë).</p> <p>Përralla: “Kësulëkuqja”</p> <p>Vjersha: “Karrota”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>

<p>E Premte</p>	<p>Përsëritje e aktiviteteve të javës</p>	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve rreth frutave dhe perimeve të stinës së dimrit, rreth vlerave të tyre ushqyese dhe dobisë që sjellin në organizmin e njeriut.</p> <p>Aktivitet sipas dëshirës.</p> <p>Vjersha: “Tren-tren Pi-Pi Tren”.</p> <p>Këngë lëvizore: “Duart nga e majta-duart nga e djathta”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
------------------------	--	--	--


Tema mujore: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e javës: “Përgatitja për festën e Vitit të Ri. Dekori, format, ngjyrat, numrat”



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Elementët dekorues të festës së Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se dhjetori është muaji i fundit i vitit, por edhe muaji i festave dhe i dhuratave.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Vjersha: “Viu viu, fryn veriu”.</p> <p>Aktiviteti: Edukatorja vendos në tapet topa zbukurues me ngjyra dhe u kërkon fëmijëve t’i japin një ngjyrë të caktuar. Më pas i nxit ata që t’i vendosin topat brenda një shporte/kutie një nga një.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>


<p>E Martë</p>	<p>Bredhi i Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të zbukurojnë bredhin. A e keni zbukuruar bredhin në shtëpi? Edukatorja i emërton fëmijëve ngjyrën e elementëve dekorues duke realizuar njohjen e ngjyrave të tyre: Çfarë ngjyre ka ylli/topi/etj?</p> <p>Aktivitet i lirë: Fëmijët së bashku me edukatoren zbukurojnë bredhin duke vendosur elementët dekorues festivë.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e dhuratave</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin dhurata, kuti të gatshme me përmasa të ndryshme, i veshin me një paketim festiv. (Përdorim letra të shndritshme dhe me ngjyra të ndryshme).</p> <p>Vjersha: “Viu viu fryn veriu”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Përgatitja e kapeleve të viti të Ri</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë kapele festive të Vitin e Ri për fëmijën e tyre.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>



<p>E Premte</p>	<p>Përgatitja e kartolinave të urimit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të përgatisin së bashku kartolinat për Vitin e Ri. Edukatorja demonstroi një kartolinë.</p> <p>Aktivitet i orientuar: Fëmijët së bashku me edukatoren përgatisin kartolinat e Vitit të Ri, duke vendosur dorën e tyre me bojë mbi to, si dhuratë speciale për prindërit.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
------------------------	--	--	--



Tema mujore: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e javës: “Programi festiv i Vitit të Ri”



Java VI	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Dekorimi i grupit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se festa po afron dhe të gjithë së bashku do të festojnë me vjersha dhe këngë Vitin e Ri. Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin vargje me punë dore për zbukurimin e ambientit në grup, vendosin pambuk në dritare ose pemë të përgatitura me punë dore.</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “Bora e bardhë” Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu”</p>	<p>Pambuk, vargje me ngjyra, topa, etj. Manuali i Vjershave dhe Këngëve.</p>

		<p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”</p> <p>Vjersha /këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	
E Martë	<p>Vjersha dhe këngë</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “Bora e bardhë” Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”</p> <p>Vjersha/këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	Manuali i Vjershave dhe Këngëve.
E Mërkurë	<p>Vjersha dhe këngë</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “Bora e bardhë” Vjersha: “Viu viu fryn veriu”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi viti i Ri”</p> <p>Vjersha/këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	Manuali i Vjershave dhe Këngëve.

<p>E Enjte</p>	<p>Vjersha dhe këngë</p> 	<p>Bisedë me prindërit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Veshja festive e fëmijës për festën e vitit të Ri (përgatitje për festën e ditës së nesërme) - Dhurata që prindi dëshiron të sjellë për fëmijën. 	<p>Manuali i Vjershave dhe Këngëve.</p>
<p>E Premte</p>	<p>Festa e Vitit të Ri</p> 	<p>Realizimi i programit festiv.</p> <p>Shpërndarja e dhuratave.</p>	<p>Manuali i Vjershave dhe Këngëve.</p>